



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**VENDIM**

**NR. 15 , DATË 23 / 07 / 2024**

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR SHTYRJEN E AFATIT TË STATUSIT**  
**“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR**  
**PROJEKTIN E INVESTIMIT "FERMË AKUAPONIKE" ME SUBJEKT**  
**APLIKUES “AQUATIQ SHPK”, NUIS L71320011G.**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13 dhe nenit 17 të ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu II, pika 8 të VKM-së Nr. 1026, datë 16.12.2015, “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, si edhe bazuar në Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 3/8, datë 15/07/2021, “Për miratimin e Statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit “Fermë Akuaponike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

**VLERËSOI:**

- Kërkesat e subjektit “Aquatiq shpk” me NUIS L71320011G janë trajtuar me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS):
  - Nr. 4/4, datë 19.04.2018, “Për Miratimin e statusit “Investim/Investitor Strategjik, Procedurë e Asistuar” për projektin e investimit me potencial strategjik “Fermë Akuaponi në Remas Lushnjë” me subjekt aplikues Aquatiq Shpk, me NUIS L71320011G.
  - Nr. 3/8, datë 15.07.2021 “Për miratimin e statusit “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar” për projektin e investimit "Fermë Akuaponike" me subjekt investues "Aquatiq Shpk" me NUIS L71320011G”.

- Nr. 3/12, datë 05.04.2022 “Për mospranimin e kërkesës së subjektit investues, shoqërisë "Aquatiq sh.p.k.” për korrigjimin e një gabimi material në zbardhjen e vendimit Nr. 3/8 datë 15.07.2021 të Komitetit të Investimeve Strategjike “Për miratimin e statusit të investitorit strategjik për realizmin e "Fermës Akuaponike”.
- Nr. 17 / 2, datë 01.02.2023 “Për mospranimin e kërkesës së shoqërisë "Aquatiq sh.p.k.” për ndryshimin e vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 17, datë 18.07.2022, dhe vënien në dispozicion të parcelave objekt i saj për realizimin në tërësi të investimit strategjik të "Fermës Akuaponike" nga subjekti "Aquatiq sh.p.k."
- Subjekti ka dorëzuar kërkesën Nr. 3/69 prot., datë 12.12.2023 pranë Sekretariatit Teknik ku ka kërkuar zgjatjen e afatit të statusit “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar”.
- Masa mbështetëse “Dhënie në përdorim të pasurisë së paluajtshme në pronësi të shtetit shqiptar” miratuar me vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 3/8, datë 15.07.2021 nuk është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, pasi gjurma e propozuar nga Komitetit Investimeve Strategjike evidenton zëra kadastralë të ndryshëm, të cilët sipas legjislacionit sektorial në fuqi paraqesin kufizime për tu vendosur në dispozicion të subjekteve dhe projekteve private.
- KIS duke marrë në konsideratë të gjithë historikun e këtij projekti investimi, si edhe duke u bazuar në faktin që Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike, në asnjë rast nuk do të konsiderohet investim, qoftë sipas kuadrit ligjor vendas ashtu sikurse dhe atij ndërkombëtar, në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se miraton në parim realizimin e një projekti investimi, materializimi i të cilit do të bazohet në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që parashkojnë legjislacionet sektoriale në fuqi,

#### **VENDOSI:**

1. Mospranimin e kërkesës së shoqërisë "Aquatiq sh.p.k” për shtyrje të afatit të statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit “Fermë Akuaponike”.

2. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet investitorit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTËR**

**EDI RAMA**

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**BELINDA BALLUKU**

**MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**

**BLENDI GONXHJA**

**MINISTËR I FINANCAVE**

**ERVIN METE**

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**

**MIRELA KUMBARO**

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

**ANILA DENAJ**

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**  
ODISE MOÇKA

**SEKRETARIATI TEKNIK I KIS**  
LAURA PLAKU (SARO)